



Kuvendi i Komunës- Gjakovë
01 Nr. /2022
Datë: 28.09.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit, 12 dhe 40.2 shkronja i të Ligjit nr. 03/L040 për vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 18.2 shkronja i të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.09.2022, pas diskutimit lidhur me pikën e 6-të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për miratimin e kërkesë për Hartimin e Draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe ndjekjen e procedurave për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim-Vendimi i Kryetarit të Komunës së Gjakovës për fillimin procedurave për hartimin e draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës .
2. Grupi Punues që do të zhvilloj procedurat për hartimin e draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës ka këtë përbërje .
 1. Znj. Nita Efendia-Brovina, Kryesues
 2. Z. Agustin Shala, anëtar- AAK
 3. Znj. Mimoza Shala, anëtare - VV
 4. Z. Bashkim Gashaj, anëtar- PDK.
 5. Z. Teki Shala, anëtar – LDK
 6. Z. Ardian Nushi, anëtar - PSHDK
 7. Z. Agim Koci, Anëtar
 8. Z. Frrok Gjergjaj, Anëtar
 9. Z. Kushtrim Brahimaj, anëtar
 10. Z. Lek Sina, anëtar
 11. Florent Koci, anëtar
3. Autorizohet Kryetari i Komunës dhe Grupi Punues i cekur në pikën 2 të këtij vendimi që ti zhvilloj procedurat e parapara ligjore për hartimin e draft Statutit të Komunës së Gjakovës dhe për ndryshimin e Simboleve të Komunës së Gjakovës, dhe pas realizmit të procedurave ti dërgoj për shqyrtim dhe Miratim në Kuvendin e Komunës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Anëtarëve të Komisionit
 - Drejtoria për Urbanizim dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - Arkivit

